

VENDIM
Nr. 227, datë 9.11.2021

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBESP TRADING & CONSULTING” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 139/6 prot., datë 2.11.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘AlbEsp Trading & Consulting’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1021 prot., datë 26.10.2021, ka paraqitur aplikimin për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Nga analiza e dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë vijon:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: “a”, “b” dhe “c”, plotësuar;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 3, germat: “a”, “b” dhe “e”, plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat “c” dhe “d”, plotësuar;

- dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika “b” dhe “c”, plotësuar.

- Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2:

- germa “c” (vërtetimi për regjistrim dhe ekstrakt historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit, QKB-ja), plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të përcjellë në ERE dokumentin e plotë në formën e kërkuar nga rregullorja (jo vetëm faqen e parë të dokumentit);

- germa “d” (vërtetimi nga prokuroria dhe gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë), plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë edhe për administratorin e shoqërisë dhe vërtetimet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për shoqërinë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., si dhe për administratorin e saj;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germa “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore), plotësuar pjesërisht. Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore.

Në vijim të letrës mbështetëse të lëshuar nga “Credins Bank” me nr. 506 prot., datë 25.10.2021, shoqëria duhet të bëjë me dije ERE-n nëse i ka plotësuar kriteret financiare të vendosura nga banka, në kuadër të mbështetjes financiare që kjo e fundit do t’i mundësojë për ushtrimin e veprimtarisë, për të cilën kërkon të licencohet;

dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8:

- geramat “a” dhe “d” (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar në gWh/sipas viteve), plotësuar pjesërisht. Shoqëria ka paraqitur sasinë e parashikuar për t’u tregtuar për tre vite të licencës, por duhet të paraqesë në ERE edhe sasinë e parashikuar për dy vitet e tjera të veprimtarisë së licencuar pasi afati i një licence është 5 vjet, do të njoftohet subjekti që në bazë të neneve 10, pika 10 dhe 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “AlbEsp Trading & Consulting” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti